

AKT THEMELIMI

I

SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"Heqimi Currency" SH.P.K

Sot, më datë 25.10.2022,

-**Aril Heqimi**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 07.07.1990, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 034108544 dhe Nr. personal J00707121B zoteron 1 kuote duke perfaqesuar 50% te kapitalit dhe

-**Z. Irvan Heqimi**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 19.09.1956 lindur në Shkodër dhe banues në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 034108287 dhe Nr. personal F60919044J, zoteron 1 kuote duke perfaqesuar 50% te kapitalit; vendosën të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe në përputhje me të.

NENI 1

Themelimi

Emri i shoqerisë është "**Heqimi Currency**" Sh.P.K. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve dhe jo vetëm, do të shënohet emri "**Heqimi Currency**" Sh.P.K.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqerisë

Objektivi i shoqerise do jete aktiviteti ne fushen e kembimit te valutave.

NENI 3

Emri dhe vula e Shoqerisë

Shoqëria del në qarkullim me emrin "**Heqimi Currency**" sh.p.k dhe Kompania do ketë vulën e vet.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Objektivi i shoqerise do jete: Kembim Valutor.



NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Shkodres me adresë: Lagjja Vasil Shanto, Rruga Fushe Cele, nr.pas.1/631-N2, z.k.8593.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë dhe Ortakët

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 2,500,000 (2 milion e pesëqindmije) lekë, i ndarë me 2 kuota, me nga 1 (një) kuote për secilin ortak.

1 kuote përfaqëson 50 % të kapitalit e cila ka vlerën 1,250,000 leke.

Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare me emrin “**Heqimi Currency**” **Sh.P.K** zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- **Z. Aril Heqimi**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 07.07.1990, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 034108544 dhe Nr. personal J00707121B zoteron 1 kuote duke përfaqësuar 50% të kapitalit.

--**Z. Irvan Heqimi**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 19.09.1956 lindur në Shkodër dhe banues në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 034108287 dhe Nr. personal F60919044J, zoteron 1 kuote duke përfaqësuar 50% të kapitalit;

Kapitali themeltar do të shlyhet plotësisht në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë me hapjen e niptit dhe hapjen e llogarive bankare.

Përgjegjësia e ortakut shtrihet deri në shumën e kontributeve të secilit në kapitalin themeltar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit Nr 9901, datë 14/04/2008 "Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve - organi më i lartë vendimarrës.

Administratori - organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 8

Administratori

Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhje.



NENI 9

Caktimi i Administratorit

Aril Heqimi, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 07.07.1990, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 034108544 dhe Nr. personal J00707121B .

Shoqeria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqerisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Organizimi dhe funksionimi i shoqerisë, ngritje e degëve apo filialeve të saj do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 12

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqerisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqerisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 13

Mosmarrëveshjet për themelimin e shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen në Gjykata kompetente.

NENI 14

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues, nënshkruhet pa vërejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKËT THEMELUES

Aril Heqimi



Irvan Heqimi

